



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 41-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.04.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Rinor Murati, anëtar
11. Armend Grajqevci, anëtar
12. Gentianë Hoxhaj, anëtare
13. Venhar Agushi, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
21. Ganimete Qeriqi, anëtare
22. Alban Salihu, anëtar
23. Fitim Meziu, anëtar
24. Fadil Spahiu, anëtar
25. Fatmir Fetahu, anëtar
26. Shahadije Dragaçina, anëtare
27. Besiana Sylja, anëtare
28. Enver Kryeziu, anëtar
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës.
3. Latif Ramadani, DBF
4. Elmaze Behluli, DA
5. Sead Aliu, DI
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Rexhep Rexhepi, DBP
8. Rasim Hasani, DKA
9. Safete Amerllahu, DGJK
10. Flamur Sylejmani, DI
11. Burim Rrustemi, DSHPMSH
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
14. Shkelzen Hajdini, DSHP
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 40-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2024.
3. Propozim Vendim mbi dhënjen e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2023 dhe 2024 në vitin 2025.
4. Informatë për punën e KKSB-së në Lipjan për vitin 2024.
5. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar – Mars 2025.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit.
7. Propozim Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.
8. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.

9. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kosova -Women 4 Women.

10. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Pastaj Kryesuesi Daut Azemi, tha ashtu siç ju kemi njoftuar edhe me heret me propzim te ekzkutivit dhe me rekomanim të KPF-së, kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës, të cilat e keni pranuar me kohë e të cilën lexoi ne vazhdim:

11. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë për subvencionim te qumështit.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me pikën e propozuar të hynë në rend të ditës dhe pas votimit u konstatua se me 22 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se unë e kam një temë për të trajtuar me disa pyetje qe ka te bëjë me azbestin i cili është një material kancerogjen i cili nëse dëmtohet liron fibra mikroskopike duke shkaktuar sëmundje të rënda të mushkërive. Një numër i madh i objekteve publike në komunën tonë janë prej azbestit, si shkolla objekte shëndetësore dhe objekte të tjera. Duke parë së fundmi demolimin e shtëpisë se kulturës kam disa pyetje? A keni formuar një grup profesional punues për ti identifikuar objektet potencialisht të ndikuara. A keni bërë ndonjë inventarizim të plotë të ndërtesave që përmbajnë azbest. A keni bërë fushatë vedisuese për qytetaret për dëmet që shkakton azbesti. A ka ndonjë raport lidhur me objekte me azbest në komunën tonë. Unë kam një propozim që të ndermirrën masat të menjëhershme për identifikimin e objekteve të azbestit. Duhet të ndermirrën masa pasi që po janë të rrezikshme për shëndetin.

Shahadije Dragaçina, tha se çështja e parë apo pyetja – vërejtja , nëse hyni në Web faqen e komunës, te zyra e kryetarit te linku për dreka dhe darka dhe aty janë vetëm deri në vitin 2021 ndërsa nuk figurojnë për vitet në vazhdim. Pse nuk janë publikuar shpenzimet për to, kur dihet që Komuna e Lipjanit thirret shumë për transparencë. E dyta me vendim të Kryetarit të Komunës është formuar komisionit për verifikimin e aseteve të cilat kane qenë në shfrytëzim nga KRP Pastrimi. Pse nuk ka një raport për këto asete. A do të lidhet kontratë prapë. Tjetra ka të bëjë me vendimin e Kryetarit për caktimin e lokacionit për auto taksi, që për qytetaret është e pa pranueshme pasi qe aty po bllokohet rruga dhe nuk është bërë zgjidhje. E fundit banoret e Magures dhe fshatrave për rreth po donë me dite pse nuk po funksionon ndriçimi publik.

Egzona Bytyqi, tha se unë i kam disa kërkesa dhe rekomandime për drejtorin e shëndetësisë. Po filloj me QMF në Shalë, i kam tri kërkesa, e para propozoj që në hyrje të këtij objekti të vendoset pjerrina, pasi qe mungon dhe është shume e nevojshme për pacientët. Tjetra në këtë institucion qe dy muaj mungon profili i punëtorit teknik. Pra me këtë nuk plotësohet as standardi bazik për hixhienë dhe punë të tjera ai punëtor teknik të cilat i ka kryer deri me tani, Unë propozoj që të përshpejtohen procedurat. Kërkesa tjetër është që inventari të ndërrohet. Tjetra të shikohet mundësi për rritjen e numrit të shtretërve në dhomën e shërbimit parenteral, për shkak të kërkesave që kemi për këtë shërbim. Do te flas pakë dhe për kujdesin paliativ unë këtë e vlerësoj se e cilësoj si shtylle vitale dhe bazament i kujdesit primar shëndetësor, mirëpo ne rrethana qe jemi është kompleks në vete, duke marr parasysh nr. e stafit, problemi me pagese orët shtese. Propozoj që me gjetë modalitete të tjera që ky shërbim me qenë në kuptimin e plotë të fjalës. Çështje tjetër e rëndësishëm decentralizmi i shërbimeve shëndetësore. E kam fjalën për ato diagnoztifike. Tjetra ka te bëjë me një petition për kundërshtimin e deponisë sanitare dua të di nëse ka përfunduar si proces a keni ndonjë përgjigje. Edhe unë pajtohem me parafolësin Arsimin për azbestin dhe duhet të mirrët çdo veprim për këtë sepse është shume i rrezikshëm dhe unë jam E gatshëme me ofruar ndihmën profesionale qoftë me ligjërata apo broshura.

Lulzim Rustemi, tha se kam një çështje dhe një pyetje për ti ngritur, e para ka të bëjë me uzurpimin e pronës komunale te rruga “Zylfie Gashi” dhe “Lulzim Llugiqi” është një pjesë mes këtyre dy rrugëve qe janë pronë komunale e po shfrytëzohet. Pronat komunale nuk ka të drejt mi shfrytëzua e as mi uzurpuar askush. Kam një pyetje, rruga prej QMI- së deri në Lipjan a keni informacion se çka do të bëhet me këtë rrugë.

Armend Grajqevci, tha se kam disa pyetje e para ka të bëjë me rrugën Poturovc Ribar i Madh është planifikuar të asfaltohet ajo rrugë me mjetet e fituara nga komuna për performancë. Kur pritet të filloj ajo rrugë. E dyta si ka ecur deri tani aplikimi për subvencionim të tokave bujqësorë. Si ekziston mundësia që të kemi një statistike se sa është tokë e punueshme ne komunën e Lipjanit. Dhe një çështje të rëndësishme që do ta ngris deri ku ka arrit procesi për themelimin e një ndërmarrje publike të komunës tonë pasi që kjo është shumë e rëndësishme. Një proces që është iniciuar qe disa vite, pres një përgjigje.

Rinor Murati, tha se kam për ti ngritur dy çështje në këtë seance, e para ka të bëjë me mungesën e adresave të numrave të objekteve –shtëpive për fshatin Shalë, jam informuar që ka një projekt nga Agjencia Kadastrale, a është edhe komuna jonë pjesë e këtij projekti. Dhe e dyta si është duke u trajtuar çështja e qenve endacak.

Ardit Cani, tha se kam disa kërkesa, e para për asfaltimin e disa rrugicave në fshatin Baince në lagjen Cani dhe në lagjen Bylykbashi. E dyta a është planifikuar diçka për asfaltimin e parkingjeve te objektet për nevoja të komunitetit. Dhe e fundit deri ku ka shkuar zhavorrimi i rrugëve bujqësore.

Shahadije Dragaçina, tha se më herët harrova për ta ngritur një çështje ka të bëjë me hulajen e madhe që është në sheshin e qytetit, e cila për mendimin tim është e rrezikshme për fëmijët, a kanë leje ato hulaja sepse aty po rrezikohen fëmijët.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se po filloj të përgjigjem nga çështja e parë që ka të bëjë me azbestin, ku ju njoftoj se ekzekutivi e ka themeluar një ekipë është ka merret goxha moti me këtë çështje, objekte në pronësi të Komunës ka pak. Jemi në fund të procesit. Ka OJQ vendore e ndërkombëtare që vlersojnë transparencën e Komunës tonë. Dreka dhe darka nuk i kam paguar askujt për atë nuk ka në faqe të publikuara. Ndërmarrja Pastrimi ka telashe, po ne e bëjmë regjistrimin e aseteve dhe ajo behet çdo vit për ti parë asetet e dëmtuara dhe ato të vjetra. Ndërmarrja ka probleme të mëdha financiare. Ne si kuvend i kemi ndihmuar disa herë ju kemi dhënë shportat e mbeturinave ju kemi dhënë edhe kamionët për bartje. Çështja e vendparkingjeve është një komision që vepron, aty ka ndodh një vend parking i përkohshëm dhe prapë është i përkohshëm deri në zgjidhjen e një parkingu tjetër . Në QMF në Shalë të gjitha ato kanë nevoja dhe mund të bëhen shpejtë, aty me së shumti ka nevoja për zgjatje të orarit. Shërbimi paliativ ka filluar shume mirë mirëpo ai shërben vetëm për raste të rënda e jo për një grip e një infuzion. Deponia sanitare në Qylagë nuk kemi ndonjë ndryshim deri tani, ne jemi kundër dhe do te vazhdojmë të mbesim po ashtu i falënderoj të gjithë qytetarët për mbështetjen qytetare dhe petition. Uzurpimi i pronave me u bërë korrekt nuk po e di ku është ai vend që e përmendet. Por na i kemi publikuar aq sa na lejon ligji listën e pronave te uzurpuara. Rruga QMI Lipjan është kompetence e ministrisë nuk e di ku jemi me këtë proces. Dhe kjo dite o ka bëhet çdo dite e me e vështire. Rruga Poturovc Ribar i Madh, është me grantin e performancës dhe pritet shumë shpejt me u publikuar. Por ende nuk ka lëshuar mjetet ministria. Subvencionet në bujqësi deri tani kanë aplikuar 1400 bujq. Sipërfaqe të tokës bujqësore e keni në raportin e zyrës se kryetarit por ju paska ikur. Themelimi i ndërmarrjes Ulpiana kuvendi ka marr vendim dhe i keni plotësuar të gjitha kriteret por deri me tani nuk është kthyer asnjë përgjigje është qe 4 vite. Dhe kjo po bëhet për arsye politike. Kjo ndërmarrje i duhet qytetarëve të komunës së Lipjanit. Mungesa e numrave në shtëpi banimi ka shume pak, një projekt që ka qenë me ASK. Për trajtimin me qentë endacak e kemi nënshkruar kontratën do të fillojmë me qytetin e Lipjanit dhe do te trajtohen të gjithë qentë. Asfaltimi i rrugicave në Baince do të asfaltohen.

Ndërsa për shtëpitë e të pamës unë e kam një projekt dhe po presim të gjejmë mjete buxhetore.

Egzona Bytyqi, tha se unë nuk e akuzova askënd, si shërbim thash paliativ është kompleks. Unë mundona me qenë principiele në kuvend. Unë e thash që kategoria me e rënd dhe kane dhimbje të pa durueshme dhe kanë nevojë me marr shërbim në çdo kohë. Unë thash me gjetë modalitete dhe alternativa nga stafi e tutje, pasi qe kjo është sfiduese. Sa i përket QMF në Shalë bëhet fjalë vetëm për një person mirëpo ka shumë frekuentim të madh dhe pa punëtor teknik është problem i madh aty.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se unë e vlerësoj çdo diskutim tëndin doktoreshë në çdo seancë jo vetëm sot sepse e shoh profesionalizmin tuaj. Unë nuk ju akuzova asnjëherë e as nuk ju akuzoj. Ju propozoni një modalitet unë e bëjë. Nuk po na lejon ligji me i paguar edhe unë i falënderoj këtë ekipe. Mirëpo unë kërkoja nga ana juaj që të ua shpjegoni qytetarëve që kjo ekipe është vetëm për raste të rënda e jo për një grip e për një lëndim të gishtit. Ndërsa në Shalë ne duhet ta bëjmë orarin 24 ore sepse është e nevojshme.

Egzona Bytyqi, tha se unë e dënoj secilin veprim dhe secilin mendim që ka tendencë me abuzuar me këtë shërbim. Jemi nder komunat e vetme që e ofrojmë këtë shërbim dhe unë në çdo diskutim dhe takim e kam ngrit larte këtë shërbim dhe mundohem me fuqizuar me kapacitetet të cilat unë i kam. Unë jam e gatshme me u ulë dhe me gjetë një zgjidhje për këtë çështje.

Shkelzen Hajdini, tha se çdo pacient i cili është për shërbim të paliativit merr shërbim dhe deri tani nuk ka asnjë pacient që ka mbet pa shërbim. Rritja e numrit të shtretërve në shëndetësi ne e kemi rritë, mirëpo infuzionet ipën me referencë të mjekut. Infuzioni kërkon kohë si shërbim. Ka hapësirë për përmirësim dhe do të përmirësohen.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 40-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 40-të e Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 40-të e Kuvendit, pas votimit u konstatua se Kuvendi me, 26 vota për , aprovoi Ekstraktin e 40-të të Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Vendim mbi dhënjen e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2023 dhe 2024 në vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se unë e vlerësoj rritjen e buxhetit, por unë kam disa vërejte te investimet kapitale te ndarja te infrastruktura ndërtimi i parkut qendror të qytetit, parkingu nëntokësor janë borxhe që janë mbet pa paguar ende. Te asfaltimi i rrugicave në disa fshatra faza e pestë projekt i ri edhe 280 mijë euro, ka nevojë për asfaltim të rrugicave, mirëpo apo harroni që më shumë ka nevojë për ujë të pijes, për arsim shëndetësi. Po ashtu janë dhe shumë shtese për bari sintetik te stadiumet, Magurë dhe Dobrajë.

Alban Salihu, tha se rritja e të hyrave po ndodh në raport me planifikimin e jo me vitin e kaluar, se nëse e krahasojmë me vitin e kaluar rritja nuk është 1 milion euro por është diku rreth 46 mijë euro. Kjo rritje po duket e tillë për shkak të keq planifikimit. Për vitin 2025 ka me pak të planifikuara se në vitin 2024. Ne do të votojmë kundër, sepse mbi 650 mijë euro ndahen për parkingun nëntokësor dhe parkun qendror dhe fushat sportive në Dobrajë dhe Magurë. Ndërsa shumë banime kanë mbet pa investime bazike.

Shahadije Bikliqi, edhe unë pajtona me parafolësit përveç që buxheti është i fokusuar në qendër te parku i qytetit dhe te stadiumet në Dobrajë dhe Magurë , prapë mjete ndahen për këto projekte, ndërsa qytetarët përballen me gjërat më elementare si ujësjellës dhe kanalizim dhe gjera tjera elementare. Kjo tregon keq menaxhim dhe pa përgjegjësi nga ana e ekzekutivit.

Armend Grajqevci, tha se ne si grup i LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim. Rritja mbi 1 milion euro është rritje e kënaqeshe dhe si pasoje e një menaxhimi të mirë. Destinimi është shpërndarë në mënyrë të duhur dhe për te mirën e qytetarëve.

Rinor Murati, tha se shumicën i potencoi parafolësi, por kam një pyetje te kontratat kolektive si është duke u menaxhuar problemi. A do te kemi rrezik për mos ekzekutim të pagesave për shërbyes publik.

Nexhmendin Lekiqi, tha se është viti i tretë që po bëhet e njëjta polemike për rritjen e buxhetit. Kur bëhet planifikimi i buxhetit ka një tavan, dhe këtu është inkasuar më shumë se tavan i caktuar po thuaj dy fish.

Latif Ramadani, tha se tavanin e të hyrave e cakton Ministria e Financave dhe ne si komunë e kemi kaluar këtë tavan dhe i falënderojmë qytetarët për kulturën e treguar për pagesë të tatimit. Kemi lëndë përmbartimore edhe këtë vit që do të na dëmtojë por kjo rritje na ndihmon.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 2 kundër, aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim mbi dhënjën e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2023 dhe 2024 në vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani, drejtor i DBF , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se u tha që kjo pikë lidhet me pikën paraprake, ne do të votojmë kundër.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, dhe 2 kunder, aprovoi propozimin

IV

Informatë për punën e KKSB-së në Lipjan për vitin 2024.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit DSHPMM i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se e përgëzoj KKSB-së, për punën e bërë si një organ mjaft i rëndësishëm. Duke e parë se janë diskutuar një mori e madhe dukurive që kanë të bëjnë me rininë dhe institucionet edukative arsimore. Propozoj që në përbërje të këtij këshilli të jetë edhe një përfaqësues nga këshilli i nxënësve.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit tha se në KKSB është e përcaktuar me ligj se kush mundet me qenë anëtar. Do te ishte mirë me qenë ne të ardhmen një përfaqësues.

Arsim Jashari, tha se vet raporti i këtij këshilli tregon që ky këshill nuk është duke funksionuar si duhet. Nëse e shohim se për çka diskutohet aty diskutohet për gropa në rrugë, e nuk diskutohet se për çka është themeluar këshilli. Por ne nuk mundemi me u arsyetuar te mos pagesa e me e neglizhuar punën. E kam lexuar raportin dhe aty asgjë nuk ka të bëjë me atë se për çka është themeluar KKSB-ja. Kam përgatitë një broshurë të shkurtër: Se pari kemi mungesë të forcimit të pjesëmarrjes së qytetarëve, është dashtë të organizohen ligjërata nepër fshatra dhe lagje për shqetësimet konkrete të banorëve, Inkurajimi për pjesëmarrje në diskutime publike të grave dhe të rejave, bashkëpunimi ndërinstitucional, rritja e koordinimit në mes policisë, arsimit dhe organizatave të shoqërisë civile, mbajtje të takimeve me drejtor të shkollave QKMF dhe këshilla të fshatrave, adresimi i çështjeve lokale dhe dukurive negative, edukimi për siguri në komunitet. Patrullime të përbashkëta policore. Në KKSB janë aktiv disa persona dhe aty fliten temat e njëjta. Duhet të jetë me funksional ky këshill.

Alban Salihu, tha se nëse e lexoni raportin shihen që ka nevojë për shumë kritika dhe tregon pafuqinë për kryerjen e shume detyrave për te cilat thirren. Si shihet në baze të raportit disa anëtar nuk marrin fare pjesë në mbledhje por edhe ata që marrin janë shumë pak aktiv. Çështja tjetër po kritikohen për shkak pse nuk po kanë mbështetje financiare për mbështetje të projekteve.

Burim Rrustemi, tha se sa i përket KKSB-se, e përcakton ligji se kush duhet të jetë anëtar. KKSB-ja, nuk ka pas buxhet të caktuar që dhe me dal në teren. Me gjithë atë si këshill është funksional dhe po ngritën shqetësime të ndryshme nga anëtarët e këshillit.

Pasi çështje tjera nuk pati, u kalua në pikën në vazhdim

V

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar – Mars 2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë do të ndalem te një temë të cilën e kam diskutuar qe 4 vite për kontratën kolektive e jo me ju terheq komunës për 3 muaj 437 mije euro në mënyrë të dhunshme të cilat kanë qenë të planifikuara diku tjetër. I merr përmbaruesi për shkak se nuk ka një vijë buxhetore për me i paguar. E di që nuk mundet me bërë marrëveshje komuna por të paktën me u krye ne procedurë të parë mos me vazhduar tutje, në shkallën e dyte e tretë. Inatet politike kane me na kushtuar gjatë, dhe këtë pasoje do ta vuajnë qytetarët.

Shahadije Dragaçina, tha se edhe në raport sikurse edhe me pikat e me hershme kritika ime është sepse shumë pak mjete po ndahen për ujë të pijes, kanalizim edhe për gjera tjera më elementare. Deri me tani për ujësjellësin në Sllovi nuk është bërë asnjë investim. Unë kam një pyetje, te raporti te bari sintetik janë shpenzuar 150 mije euro, ku kane shkuar ato mjete.

Lulzim Rrustemi, tha se po e diskutojmë raportin e shpenzimeve dhe të hyrave Janar – Mars 2025 një raport i rregullt. Një raport ku ne këtë periudhe është shpenzuar mire dhe ka një ecje të mirë. Te investimet kapitale kemi më pakë shpenzim. Te granti qeveritar te investimet kapitale dhe këtu shpenzim i mirë . Te kultura, rini, Sport shpenzim zero. Po ashtu te granti qeveritar janë shumë projekte me shpenzim zero. Te ekzekutimi i pagave nga thesari duhet të ceket për ka janë marr. Te derivatet ka një shumë të madhe të shpenzimit. Te përfituesit individual ka shumë shpenzim po ashtu. Një raport që ka një shpenzim të mirë në përgjithësi.

Besiana Sylja, tha se nëse e shikojmë raportin e shpenzimeve dhe të hyrave Janar Mars 2025 kemi një shpenzim mbi 22% qe është një shpenzim i vogël. Te raporti te grupi 16 keni një gabim sepse e keni ne gjuhën serbe. Unë kam një pyetjeje te tatimi në pronë pse është kjo përqindje kaq e vogël më krahasuar me vitin e kaluar.

Latif Ramadani, tha është një raport periodike për secilin shpenzim që ka ndodh është një raport real. Te kontratat kolektive prej vitin 2019 deri sot ne kemi kërkuar me u bërë një zgjidhje mirëpo nuk ka pas gatishmëri nga Ministria e

Financave. Ky problem do të na përcjelle dhe vitet në vazhdim. Te ujësjellësi nuk ka shpenzim sepse nuk ka filluar. Te transferet është për bursa subvencione, shërbime të varrimit. Shpenzimin do ta bëjmë ashtu siç e kemi planifikuar.

Shahadije Dragaçina, tha unë vetëm pyetje bëra se ku janë shpenzuar ato mjete sepse nuk po figuron se ku janë shpenzuar.

Latif Ramadani, tha se bari sintetik është në shpenzim po ashtu te ujësjellësi ka filluar shpenzimi.

Pastaj Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit dha pauze prej 5 minuta

Pasi çështje tjera nuk pati, u kalua në pikën në vazhdim.

VI

Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se është një plan i mirë që duhet përshëndetur dhe në grupi i PDK-së, e mbështesim këtë plan. Duhet të kemi kujdes të qartësisë së objektivave, të bëhet përfshirja e akterëve relevant pasi që janë disa institucione. Sigurimi i burimeve financiare dhe sensibilizimi i opinionit publik, monitorimi i rregullt. Te përgatitja profesionale duhet me pas kujdes. Është një plan i mirë

Rinor Murati, tha se trajtimi i një çështje të tillë është mjaft e rëndësishme, është për tu përshëndetur edhe mbështetja stimuluese komuna që ua ofron familjeve strehuese. Kam një pyetje aktualisht sa fëmijë janë pjesë e Sos Fshatrave pa përkujdesje prindërore a keni informatë.

Shahadije Dragaçina, tha se në raportin që e paraqiti drejtori u ceken që janë 3 fëmijë, mirëpo sa është numri i fëmijëve që janë në pritje. A ka një numër.

Lumturije Bytyqi- Hasani, tha se hartimi dhe miratimi i këtij plani është një hap i madh nga ana e komunës për të bërë një zgjidhje për një kategori që janë fëmijët pa strehë. E kam lexuar në detaje këtë plan, uroj që komuna do ti arrij objektivat duke e

rritur numrin e familjeve strehuese. Unë e pash që ka 3 fëmijë, por a ka mekanizma që monitorojnë jetesën e atyre fëmijëve pra a i zbatojnë kriteret e kontratës ato familje.

Fitim Mëziu, tha se ky është një prej vendimeve më të rëndësishme për ardhmërinë, pasi që investimi dhe mbështetja e këtyre fëmijëve për një mjedis të sigurt edukativ, është një çështje shumë e rëndësishme e cila duhet të gjithë neve të na preokupoj dhe ti kushtoj një rendësi shume të madhe. Te gjithë duhet me i falënderuar për një pune të rëndësishme qe këta fëmijë të kenë në një të ardhme shumë më të mirë.

Gazmend Qerkini, tha se shumicën e pyetjeve i thane parafolësit unë vetëm dua të ndalem miratimi i këtij plani sa është human ashtu edhe njerëzor. Dhe duhet falënderuar të gjithë ata qe kanë kontribuar me hartimin e këtij plani po ashtu edhe komunën për mbështetje financiare për këto familje.

Shkelzen Hajdini, tha janë një sër objektivash, por mund edhe tjera të avancojmë. Monitorimi do të bëhet sepse pa fazën e monitorimit ky plan është vështir të implementohet pasi që është esencial. Me këtë plan formohen dhe ekipe monitoruese dhe në fund raporton edhe për gjendjen e familjeve strehuese. Deri tani i kemi 3 fëmijë, dhe me vendim të kryetarit paguhen nga komuna jonë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini, tha se a do të vazhdoj shkëputja e kontratave për të gjithë ata që i kanë marr këto prona.

Alban Salihu, tha se për shkak se në të kaluarën nuk ka pas transparencë në dhënie ne shfrytëzim të pronave ne do të votojmë kundër.

Valon Pacolli, tha se me vendim te Kryetarit të Komunës është themeluar një komision për monitorimin e pronave që janë dhënë në shfrytëzim, dhe çdo prone monitorohet

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, dhe 2 kunder, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, I cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj tha se në emër të grupit të LDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë Armend Grajqevcin

Egzzone Bytyqi, tha se ne emër te grupit të PDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Lulzim Rustemin

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se përbërja e Komisionit është si vijon

1. Valon Pacolli nga ekzekutivi i Komunës,
2. Rexhep Rexhepi nga ekzekutivi i Komunës,
3. Armend Grajqevci nga subjekti politik, LDK
4. Lulzim Rustemi, nga subjekti politik PDK dhe
5. Bekim Krasniqi nga sektori joqeveritar lokal

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, dhe 5 abstenim, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kosova -Women 4 Women.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha kur është hartuar buxheti vitin e kaluar kam kërkuar nga komuna që të kenë fokus gratë e marginalizuara dhe të ndahet buxhet. Po me vjen mirë që komuna ka gjet një modalitet tjetër dhe mirë që po vazhdoni, por unë propozoj që të jenë pjese e kësaj gratë e marginalizuara gratë që janë të pa punësuar. Ne do ta përkrahim fuqishëm këtë propozim.

Valon Pacolli, komuna e ka mbështet çdo iniciative dhe për këtë ka pas një thirrje të hapur për aplikim.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se me ligjin e ri çdo konkurs që hapet duhet komision i ri, e dyta pa u hap konkursi nuk mujna me shpall vendimin për formimin e komisionit. Afatet kalojnë dhe nesër mundet ligjshmëria me u kthye dhe ky është një problem i madh. Në e mbështesim këtë propozim vendim.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës tha se parafolësi ka drejt dhe kjo është absurde me thënë të drejtën e pa kuptueshme me u formua komision nga kuvendi për çdo konkurs veç e veç. Kjo është analfabetizëm i njerëzve që menaxhojnë me këtë fushë.

Alban Salhiu, tha se ne këto komisione i konsiderojmë si pune formale sepse dihet se kush i përzgjedh drejtoret e shkollave në Lipjan.

Rasim Hasani, tha se me ligj është e përcaktuar se Kryetari i Komunës i për zgjedh drejtoret dhe zëvendës drejtoret e shkollave.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 1 abstenim, aprovoi propozimin

XI

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë për subvencionim te qumështit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtor i DBPZHR , cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nëse dikush nga anëtarët e kuvendit është përfitues i subvencionit mos te votoj, ka te drejte te diskutoj por jo të votoj.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne e mbështesim këtë propozim vendim, por është mirë nga viti i ardhshëm të bëhet në

8 cent nga 4 cent.

Armend Grajqevci, tha se ne si familje vijmë nga dikasteri i bujqësie dhe kjo është një ndihme e madhe nga ana e komunës. Une nuk do te marr pjese ne votim.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 12:45

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi